



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.10105/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 Neni 11 , 40. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 merr:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EKSPLOATIM TË MINERALIT TË KROMIT PËR KOMPANIN ACHRO-SH.P.K

I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë “ Achro-” sh.p.k Prishtinë për eksploatim të mineralit të kromit në parcelat kadastrale P-73317019-01440-2 me kulturë tokë jo pjellore zona kadastrale Gorancë në vendin e quajtur Rudine pronë e Ekonomisë Pyjore dhe parcela kadastrale me numër P-73317019-01446-0 me kulturë kullosë e klasit shtatë (7) zona kadastrale Gorancë në vendin e quajtur Rudine pronë e Ekonomisë Pyjore komuna Hani i Elezit.

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelat e lartshënuar me plan rregullativ hapësinor nuk ka planifikuar ndonjë projekt që pengon këtë veprimtari, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet t'i drejtohet Agjencionit të Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e Ekonomisë Pyjore.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 20. 12. 2018

Kryesuesi i Kuvendit
MSc Oamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9908/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni Nr. 03/L-040 nenit 11, 12, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2018 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
PËR VITIN 2019

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

II

Plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2019 përmban aktivitete dhe objektivat e punës së ekzekutivit të komunës në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe Statutit të Komunës.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:20.12.2018

Kryesuesi i Kuvendit
MSc Qamush Brava





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 9907/2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, 68, Ligjit për Qasje në Dokumente Publike Nr. 03/L-215, Udhëzimit Administrativ për Transparencë në Komuna Nr.01/2015, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 39, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12. 2018 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR TRANSPARENCË PËR VITIN 2019

I

Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës për transparencë për vitin 2019.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës për transparencë për vitin 2019.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendimi njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Administratës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 20.12. 2018

